



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SEKTORI I KOORDINIMIT NDËRKOMBËTAR PROJEKTEVE DHE KËRKIMIT
SHKENCOR

Prot. 1123 No.

Gjirokastrë, on 07.07.2025

APROVOI
REKTORI

Prof. dr. Jaho ÇANA



Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ në Universitetin Mesdhetar të Kretës.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Kretës hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndër-Institucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me **2 pozicione** për studentë të Departamentit të Infermierisë, cikli i parë i studimit (Bachelor), viti i tretë, të cilët do të angazhohen në praktikë mësimore në Universitetin Mesdhetar të Kretës. Praktika do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2025-2026**, semestri i parë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht ose greqisht.

Kriteret e përzgjedhjes:

Studentët do të përzgjidhen bazuar në implementimin e Marrëveshjes Ndër-institucionale në Kuadër të Programit "Erasmus+" KA107 International Credit Mobility", sipas kriterëve të mëposhtme:

- Merita akademike.
- Kompetenca gjuhësore.

Në rast të kandidatëve me pikë të barabarta:

- Prioritet do t'u jepet studentëve që u përkasin grupeve me diversitete sociale ekonomike, gjinore, racore, ngjyre, aftësi të veçanta, etj.
- Barazia gjinore (aty ku është e mundur, të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).
- Prioritet do t'u jepet studentëve që nuk kanë përfituar më parë nga programi Erasmus+ KA1.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **10.07.2025**:

- vërtetim studenti;

- listë notash;
- letër interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS në anglisht;
- vetëdeklarim / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze në nivelin B2 ose të gjuhës greke në nivelin B1;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dorëzimi i dokumentave të aplikimit kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Elektronikisht (të skanuara në formatin pdf) në adresat:
a) iro@uogj.edu.al
- Dorazi pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor.

Procedura e përzgjedhjes:

- UGJ ngre një komision *ad-hoc*, i cili do t'i rendisë kandidatët në bazë të skemës së pikëzimit si dhe kriterëve të thirrjes.
- Kandidatët fitues do të njoftohen prej SKNPKSH në adresën e tyre të email-it.
- Kandidatët aplikues kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të komisionit *ad-hoc* pranë Rektorit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.
- Në përfundim të afatit të ankimit, SKNPKSH përcjell listën e studentëve të nominuar pranë universitetit pritës.
- Studentët e përzgjedhur do të kontaktohen prej universitetit pritës për të vazhduar më tej me procedurat e nevojshme.

Për më shumë informacion rreth skemës së mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit mund të kontaktoni me:

- Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor (iro@uogj.edu.al).

Zv/Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita ISARAJ

Konceptoi: Irma Gjollëshi


